


REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SHTIME
Zyra e Prokurimit



Nr. 03/1/58

Datë 27.9.2018

Kontratë
(Punë)

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit Havë Qarri , në njëren anë; dhe

“TRIANGLE” SH.P.K.,SUHAREKË, pronar Arian Bytyçi tel. 049-479-341 , ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

"Renovimi i objekteve Shendetesore ne Shtime " me numër Identifikues 617-18-6352-5-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë "Renovimi i objekteve Shendetesore ne Shtime "

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 27.9.2018 dhe përfundon me 26.10.2018

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i *[ekzekutimit të punëve]* *[kryerjes së shërbimeve]* do të jetë *QMF në Shtime*

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4493,50 €**; Katërmijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre Euro e pesëdhjetë cent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimi të tërë dërgesës]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[shërbimeve]* *[punëve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancia

7.1 Garancia do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimi të *[shërbimeve]* *[punëve]*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]* *[të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet]* *[të kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë

dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.




Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [shqipe]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues


Emri:	ARIAN BYTJARI	Emri:	Havë Qarri
Pozita:	DIREKTOR	Pozita:	U.D. Menaxher / Autorizim
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	27.09.2018	Data:	27.09.2018
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Renovimi I objekteve shëndetësore në Shtime


Vërejtje: Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vurjen në vepër të materialeve për secilin pozicion

1.1	PUNETE NGROHJES				
	Përshkrimi I punëve. Ne përputhshmëri të plote me standartet EC dhe ISO.	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1.1.1	Liferimi dhe montimi I tubit të çelikut DN 50	m'	70	8	560.00 €
1.1.1	Izolimi termik me armaflex të gypave(dërgues dhe kthyes) d=9mm	m'	70	1.6	112.00 €
1.1.2	Liferimi dhe montimi I valvolave me flanaxhe dhe kunderflanaxhe, me bulona, diktung DN 50 per montim ne kaldatoren ekzistuese ne ket pozicion te kalkulohet edhe zbraza e sistemit per montim te termostabilimenteve po ashtu edhe mbushja e sistemit me uji	cope	3	90	270.00 €
1.1.3	Hapja e kanalit me gjersi a=0.7 m dhe thellsi h=1.2m, per vendoren e gypit te ngrohjes nga çeliku DN 50	m'	30	1.5	45.00 €
1.1.4	Fitingu për gypat e çelikut si mbajtës, kthesat, tegeli, gasi për saldim etj. është 50% nga pozicioni i gypave	m'	0.5	550	275.00 €
	TOTALI:1.1				1,262.00 €
1.2	PUNËT TJERA				
1.2.1	Furnizimi dhe mveshja e dyshemesë me pllaka keramike të tipit "MAT-TE PA RRESHQITHEME" të klasit parë 20/30cm vendosja e pllakave me llaq adekuat.Në shkallet para hyrjes ne QKMF, ndërsa ngjyra dhe kualiteti i pllakave duhet të caktohet nga mbikqyrësi. Llogaria në m ²	m ²	25	15.5	387.50 €
1.2.2	Furnizimi dhe vendosja e kubëzave të betonit me trashesi t=8cm duke perfshire edhe rreren 0-4 per te vene ne veper kubzat,kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjera ngrirje shkrirje-krypëra, abrazion.Forma e tyre perzgjedhet nga investitori.	m ²	63	8	504.00 €
1.2.3	Furnizimi dhe vendosja e skajorëve 18/24 kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjera ngrirje shkrirje-krypëra, abrazion.	m'	25	7	175.00 €



TRIANGLE
SH.P.K.
SUHAREK

1.2.4	Furnizimi dhe vendosja e skajorëve 8/20 kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjera ngrirje shkrirje-krypëra, abrazion.	m'	25	5	125.00 €
1.2.5	Hapja dhe punimi i koritës nga Betoni mbrapa objekti te QKMF-së me gjersi b=0.5m dhe lartësi 0.7m dhe trashësi 0.1m.	m ³	4	50	200.00 €
1.2.6	Furnizimi dhe montimi i ujëmbledhësit për kullimi e ujrave atmosferik te koritës mbrapa objekti të QKMF-së me dimensione 20x20 cm ne kete pozicion te kalkulohet edhe kyqja e ujmbledhësit ne rrejtin e kanalizimit atmosferik.	copë	1	50	50.00 €
1.2.7	Furnizimi me material dhe punimi i dyshemesë me laminat të klasit të parë në katin e dytë të QKMF-së .Në kete pozicion te kalkulohet edhe vendosja e folisë nivelizuese si dhe këndet ne perimenter te hapsiravë. Llogaria në m ²	m ²	120	8	960.00 €
1.2.8	Furnizimi dhe montimi i gypave Gypat PE - Xa te klasit te pare duke perfshire dhe të gjitha pjesët e nevojshme fazonike. Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet. Ne cmim te llogaritet testimi dhe dezifektimi rrjetit. Gypi uje Pex : Ø 16 mm (1/2")	m'	10	2	20.00 €
1.2.9	Furnizimi dhe montimi i gypave për instalimin e kanalizimit duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme fazonike Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet: PVC Ø 50 mm	m'	10	2	20.00 €
1.2.10	Demolimi i pllakave per vendosjen e dy gypave ne sallën e stomatologjisë me gjersi b=0.25 m dhe gjatësi l=10.0m .Ne kete pozicion te kalkulohet edhe rikthimi i pllakave te qeramikes ne gjendjen adekuate.	copë	1	100	100.00 €
1.2.11	Furnizimi dhe montimi i reklamës me mbishkrim te QKMF-së me ndriqim LED me dimensione 0.8x1.5 m .	copë	1	250	250.00 €
1.2.12	Zhvendosja e gjeneratorit me paisje adekuate (kran) nga nje pozion ne nje tjetër	copë	1	190	190.00 €



1.2.13	Furnizimi dhe montimi I I gypit nga B/A per pusin ne Petrovë me dimensione Ø1000 mm ne ket pozicion te kalkulohet edhe punimi I kuroros nga betoni.	copë	1	90	90.00 €
1.2.14	Funksionalizimi I rrjetit te kanalizimit Fekal ne Ambullantën në fshatin Pjetershticë, elementet duhet te jene identike me ato ekzistueset.	m'	40	4	160.00 €
TOTALI:1.2					3,231.50 €

REKAPITULLIMI TOTAL		
1.1	PUNETE NGROHJES	1,262.00 €
1.2	PUNËT TJERA	3,231.50 €
Shuma e subtotaleve:		4,493.50 €

Identifikimi i Operatorit Ekonomik	
Emri i Kompanise	"TRIANGLE" SHPK
Adresa e Plote	RR.BRIGADA 123 PN, SUHAREKE
Perfaqesuar Nga:	
Emri	ARIAN BYTYÇI
Pozita	DREJTOR
Nenshkrimi	
Data	12.09.2018
Vula	

